



**SiCRED - 8 MUJORI - e vetmja me rritje nga shoqëritë e sigurimit të Jetës, dëshmohet me 105.000 Euro pilotët e rënë në krye të detyrës**

# 2016 - Viti i Sigurimit të Jetës dhe Kursimit, SiCRED me fokus te produktet financiare

**S**hoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a., ka dëshmohet familjarët e dy pilotëve të rënë në detyrë, sipas marrëveshjes siguroese me Ministrinë e Mbrojtjes. Në datën 6 prill 2016, helikopteri i forcave të armatosura në të cilin udhëtonin 3 ushtarakë është rrëzuar në liqenin e Shkodrës, duke u marrë jetën 2 pilotëve.

Dy pilotët rezultojnë të siguar, sipas Kontratës së Sigurimit "Për Sigurimin e jetës së efektivit fluturues", të lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Bashkimit të Operatorëve. Bazuar në këtë kontratë, SiCRED sh.a. ka paguar shumën prej 14.4 milion lekë në favor të familjarëve të ushtarakëve të rënë. Kjo është hera e parë që SiCRED sh.a. bën një pagesë e tillë për pjesëtarët e Forcave të Armatosura që humbin jetën në krye të detyrës, duke qenë pranë familjarëve të ushtarakëve, për të lehtësuar mungesën e thellë të lënë pas nga ndarja e parakohshme nga jeta e të dashurve të tyre.

## SiCRED rreth 25% të Tregut e Sigurimit të Jetës në mbyllje të 8-mujorit

SiCRED ka patur një aktivitet të suksesshëm gjatë vitit 2016. Krahasuar me 8-mujorin e vitit 2015, vetëm SiCRED pati rritje të primeve të shkruara në tregun e sigurimit të jetës, me një rritje të vëllimit të primeve të shkruara bruto prej 7.3%.



Kjo performancë pozitive ka rezultuar dhe

në përmirësimin e pjesës së tregut të SiCRED, e cila ka arritur në 25%, krahasuar me 22% të së njëjtës periudhë të vitit 2015.

## Produkte sigurimi për përfitimeve financiare afatgjata

Misioni i SiCRED është të jetë partneri kryesor financiar për individin, duke e shoqëruar atë përgjatë gjithë jetës, nëpërmjet ofrimit të produkteve të sigurimit të përshatshme me kërkesat dhe nevojat e individit në çdo fazë të jetës së tij. Gjatë vitit 2016, SiCRED është fokusuar në ofrimin e produkteve të sigurimit me element kursimi afatgjatë, të cilat i mundësojnë të siguarit përfitime dyfishe: sigurim dhe kursim.

Sigurimi i Jetës (me Mbijetesë), i prezantuar vetëm pak muaj më parë nga SiCRED, garanton për të siguarin një shumë monetare (Shuma e siguar) e cila është e pagueshme në rast vdekje apo mbijetesë. Bashkë me këtë sigurim, individit mund të zgjedhë dhe sigurimet shtesë nga aksidentet dhe sëmundjet kritike. SiCRED është e para kompani sigurimi në treg që ofron kombinimin e sigurimit të jetës afatgjatë me element kursimi me sigurimin nga sëmundjet kritike, një sigurim i cili i ofron të siguarit një shumë monetare në rast të shfaqjes së një prej sëmundjeve kritike (sëmundje të rënda), gjatë periudhës së sigurimit. Kështu, i siguarit do të ketë të ar-



dhura të mjaftueshme për të përballuar kurimin e tij, pa vënë në rrezik planet e tjera financiare të familjes.

Në Sigurimin e Jetës (me Mbijetesë), pjesa e primit të sigurimit që kursehet rregullisht, investohet me një normë minimale të garantuar prej 1.2%. Në një kohë kur depozitat në monedhë të rënda si Euro apo Dollarë Amerikanë, kanë një normë interesi pothuaj 0% e në disa raste edhe negative, ky produkt paraqet një alternativë shumë të mirë investimi afatgjatë. Gjithashtu, produkti i sigurimit i jep të drejtën individit të marrë pjesë dhe në fitimin e realizuar nga kompania për portofolin e këtij produkti, duke maksimizuar përfitimet e individit nga ky sigurim.

Këto produkte sigurimi ju ndihmojnë të jetoni sot më të qetë dhe të lumtur dhe të ndërtoni të ardhmen tuaj ashtu siç ju e imagjoni. Duke investuar shuma të vogla sot në formën e primit të sigurimit, produkti i sigurimit mundëson të keni një shumë të madhe parash nesër, pikërisht atëherë kur ju nevojitet.

SiCRED garanton klientët e saj së në vijim do të ndërmarrë fushata edukimi intensive nëpërmjet burimeve të saja për edukimin e konsumatorit shqiptar në lidhje me përfitimet që klientët e saj kanë nga produktet e Sigurimit, e veçanërisht produktet financiare.